



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



**Ministria e Administratës Publike / Ministarstvo Javne
Administracije / Ministry of Public Administration**

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION

PLANI PËR INTEGRITET

(2024 – 2026)

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE

Prishtinë

26 janar 2024

PËRMBAJTJE

1. Deklarata për Integritet.....	3
2. Vendimi për emërimin e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit.....	4
3. Hyrje.....	5
4. Plani për Integritetit.....	7
5. Procesi i Zhvillimit të Planit për Integritet.....	7
6. Analiza e akteve normative.....	8
7. Matrica e vlerësimit të intensitetit të rrezikut.....	9
8. Monitorimi dhe Raportimi i Zbatimit të Planit për Integritet.....	10
9. Matrica e Identifikimit të Rreziqeve.....	12
10. Vendimi për miratimin dhe hyrjen në fuqi të planit të integritetit.....	19

1. Deklarata e Integritetit

Duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, gjegjësisht nenit 25, të gjitha organet e administratës qendrore, agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale të Kosovës obligohen që të miratojnë planet e integritetit, andaj ne baze te kësaj, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Kosovës për Administratë Publike në mbështetje të nenit 7, pika (2.3) e Ligjit Nr.04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe nenit 12, paragrafi I nën-paragrafi 1.5, Nenit 25, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08 / L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022),udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për planin e integritetit të miratuar nga Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nxori vendim për themelimin e grupit te punës për hartimin e Planit te Integritetit për IKAP.

IKAP është në mesin e institucioneve kryesore me ndikim të veçante në reformën e administratës publike dhe partnere e shumë organizatave dhe projekteve që ofrojnë mbështetje në zhvillimin e burimeve njerëzore në shërbimin civil dhe administratën publike në përgjithësi.

Plani i Integritetit është një dokument që tregon përkushtimin e institucionit ndaj integritetit dhe përcakton politikat dhe procedurat që do të përdoren për të arritur këtë qëllim. Plani i Integritetit duhet t'iu përshtatet nevojave specifike të organizatës, por në përgjithësi duhet të përfshijë elementët e mëposhtme: përkufizimin e integritetit dhe rëndësisë së tij, vlerësimin e rreziqeve aktuale të integritetit të organizatës, një tërësi qëllimesh dhe objektivash për planin e integritetit, politikat dhe procedurat për të adresuar rreziqet e integritetit, si dhe procesin e monitorimit dhe vlerësimin e efektivitetit të Planit të Integritetit.

Plani i Integritetit tani me është kërkesë ligjore dhe IKAP-it do të i mundësoj krijimin e besimit me institucionet bashkëpunuese, pjesëmarrësit, trajnerët dhe të gjitha palët e interesit për ruajtën dhe rritjen e ndikimit që ka në fushën e trajnimit dhe aftësimit të nëpunësve civil dhe administratës publike në përgjithësi.

Lule Isufi, U.d. Drejtore e përgjithshme, IKAP/MPB



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme/Ministertva Unutrašnjih Poslova / Ministry
of Internal Affairs

INSTITUTI I KOSOVES PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME/ MINISTERTVA UNUTRAŠNJIH POSLOVA	
MINISTRI - ZADAR: U. DREJTORE PËR PËRGJITHSHME	
INSTITUT I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE - INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU	
Kopje Nr. 01	A. P. Nr. 005
01	15.01.2024

Nr. 005/2024
Datë: 15/01/2024

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Kosovës për Administratë Publike në mbështetje të nenit 7, pika (2.3) e Ligjit Nr.04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike dhe nenit 12, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5, Nenit 25, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08 / L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planit të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për planin e integritetit të miratuar nga Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Caktohet Grupi Punues për hartimin e Planit të Integritetit, me përbërjen si në vijim:
 - 1.1 Bujar Thaçi - kryesues /koordinator
 - 1.2 Basci Berisha - anëtar
 - 1.3 Vloca Kryeziu - anëtar
 - 1.4 Besart Mulaj- anëtar
 - 1.5 Jehona Podrimiqaku – anëtar
2. Obligohet grupi punues të përgatis një program për hartimin e Planit të Integritetit, sipas udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara më Metodologjinë për Planin e Integritetit.
3. Grupi Punues përfundon hartimin e Planit të integritetit jo më vonë se 26 janar 2024.
4. Obligohet i gjithë stafi i IKAP-it për bashkëpunim dhe ofrimin e të dhënave të kërkuara nga Grupi Punues. Kryesuesi i këtij Grupi Punues, sipas nevojës mund të kërkojë angazhim të zyrtarëve të tjerë shtesë.
5. Vendimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit.

Luëtsufi

U.d. Drejtore e Përgjithshme IKAP

Vendimi U'i dërgohet:

- Anëtarëve;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të IKAP.

2. Hyrja

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Instituti i Kosovës Për Administratë Publike, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i Integritetit është një dokument i brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohen çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së integritetit brenda Institucion dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Institucion.

Plani rritet përkushtimin e Instituti të Kosovës Për Administratë Publike për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të IKAP-it.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

3. FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT:

1. Udhëheqja dhe Menaxhimi;
2. trajnimit, aftësimin profesional dhe zhvillimi i kapaciteteve në shërbimin civil;
3. Planifikimi dhe Menaxhimi i Financave;
4. Ruajtja dhe siguria e të dhënave digjitale;
5. Regrutimi dhe plotësimi i vendeve të lira të punës.

4. FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT

1. Angazhimi i trajnerëve;
2. Hartimi i moduleve;
3. Sigurimi i pjesëmarrjes;
4. Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm.

5. PLANI PËR INTEGRITETIT

Plani i Integritetit për IKAP është hartuar duke u mbështetur në dokumentin e Metodologjisë së Planeve të Integritetit, i aprovuar më 26.07.2023.

Plani i Integritetit është dokument i brendshëm tre (3) vjeçar, që përcakton vlerësimin e rrezikut të korrupsionit dhe formave tjera që e cenojnë integritetin, si dhe masat parandaluese. Si i tillë, plani shërben për identifikimin e rreziqeve, analizën dhe vlerësimin e rrezikut dhe specifikon masat, sipas rreziqeve për arritjen e objektivave të saj të integritetit, për të avancuar performancën e integritetit në sektorin e administratës publike dhe fuqizimin e sundimit të ligjit dhe vlerave e standardeve profesionale.

Qëllimi i Planit të Integritetit është definuar edhe në metodologjinë e planeve të integritetit:

- Identifikimi i proceseve të ndjeshme ndaj sjelljeve dhe veprimeve që mund të jenë korruptive;
- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion, që synon respektimin e kërkesave ligjore, procedurale dhe kuadrit të brendshëm normativ;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë për të siguruar rritjen e besueshmërisë publike në qeverisjen dhe në performancën e integritetit të sektorit publik;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit, përmes përmirësimit të kontrolleve operationale në fushat e funksionimit të institucionit dhe proceset e punës me rrezik korrupsioni;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion, me fokus në fushat me rrezik të lartë të cenimit të integritetit, duke synuar integrimin e këtij procesi në kulturën institucionale.

Përmes Planit të Integritetit IKAP synon:

- Rritjen e mundësive që institucionit të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuara;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga Institucioni.

6. Qëllimet e Planit të Integritetit të IKAP

- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

7. PROCESI I ZHVILLIMIT TË PLANIT PËR INTEGRITET

Hartimi i Planit të Integritetit për IKAP ka kaluar nëpër disa faza:

- **Faza e parë:** U.d. i Drejtorit të përgjithshëm të IKAP-it, me datë 15.01.2024, ka marr vendim për emërimin e Kryesuesit dhe Anëtareve të Grupit Punues për Hartimin e Planit të Integritetit, si dhe emërimin e personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit.

Gjatë kësaj faze, Kryesuesi i Grupit Punues, më 15.1.2024, përmes emalit, ka shpërndarë vendimi dhe dokumentet e nevojshme për hartimin e planit të integritetit dhe ka kërkuar të mbahet takimi i parë i grupit punues. Në takimin e grupit punës është diskutuar për ecurit e punës, ndarjen e detyrave dhe u vendos të behët shpërndarja e pyetësorit standard tek të gjithë stafi i IKAP-it. Afati për kthimin e pyetësorëve të plotësuar u caktua deri më datë 21.01.2024 ora 12:00. Qëllimi i pyetësorëve është që anëtarët e grupit punues të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm varësisht nga përgjegjësit që ata i mbulojnë, pasi që analizimi i tyre është i domosdoshëm, me qëllim të identifikimit të faktorëve të rrezikut që cenojnë integritetin e IKAP, e që si rezultat do të kontribuojë për hartimin e planit të integritetit për IKAP.

Dokumentacioni ka përfshirë (ligjet, aktet nënligjore, rregullat për organizimin dhe sistematizimin, kodet e ndryshme, udhëzimet, udhëzuesit, raportet financiare, raportet e auditimit, raportet e ndryshme vendore e ndërkombëtare për IKAP.

- **Faza e dytë:** Grupi punues ka zhvilluar përsëri një takim të përbashkët më 25 janar 2024, ku ka shqyrtuar rregullativën ligjore të gjitha akteve me qëllim që të identifikoj rreziqet brenda institucionit.

Në këtë takim grupi ka punuar për identifikimin e rreziqeve për fusha të përgjithshme dhe fushave të veçanta, si dhe masat për eliminimin e tyre. Në fund të takimit janë propozuar rreziqe dhe masa për eliminimin e tyre.

Rreziqet dhe Masat e propozuara në këtë takim janë diskutuar përsëri me anëtar të grupit punues, të cilave ju është caktuar niveli i rrezikshmërisë si dhe janë dhënë edhe disa propozime që të përfshihen në Planin e Integritetit.

		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Intensiteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)	i	Ulët			Mesatar				Lartë		
		Probabiliteti/Gjasat									

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të cenimit të integritetit vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

 **Rreziku me intensitet të ulët** – mundësia e ndodhjes së cenimit të integritetit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit, (rreziku nuk u shfaq në të kaluarën ose shfaqet shumë rrallë, kështu që nuk ka gjasa që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen).

Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut - Ndikimi për integritetin e institucionit është i parëndësishëm.

 **Rreziku me intensitet të mesëm** – ndodhja e cenimit të integritetit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik, (rreziku është shfaqur në një numër rastesh në të kaluarën, kështu që probabiliteti i ndodhjes në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen është i moderuar).

Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut - Ndikimi i është i rëndësishëm për integritetin e institucionit.

 **Rreziku me intensitet të lartë** – cenimi i integritetit ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin, (rreziku është shfaqur shpesh në të kaluarën dhe ekziston një gjasë e madhe që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen).

Vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së rrezikut – Ndikimi është shumë i rëndësishëm për integritetin e institucionit.

9. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I ZBATIMIT TË PLANIT PËR INTEGRITET

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, përmes zyrtarit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit për Integritet. Plani i Integritetit do të rishikohet periodikisht dhe do të përditësohet në përputhje me zhvillimet që ndërlidhen me institucionin, procedurat dhe shërbimet që ofrohen nga IKAP dhe parterët.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi do të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm, përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioritetëve të rrezikut, si dhe kanë identifikuar cilat mësimë duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë duke u arritur.

Personi përgjegjës për zbatimin e Planit të Integritetit, raporton lidhur me zbatimin e Planit të Integritetit, çdo gjashtë (6) muaj brenda Institucionit.

Raporti pas hartimit dhe aprovimit paraprak nga udhëheqësi i institucionit dhe grupi punës, do të dërgohet në Agjencinë për Parandalim të Korrupsionit.

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësim i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia / zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	Udhëheqja dhe Menaxhimi	Transparenca dhe llogaridhënia.	Ligjet dhe aktet nënligjore; Ligji Nr. 04/L-221 për Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP); Ligji Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik	3	6	18	Transparencë në vendimmarrje dhe publikimi i të gjitha vendimeve në web faqen e IKAP-it.	Drejtori i Përgjithshëm i IKAP-it.	Në vazhdimësi
	Konflikti i interesit	Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesit e aprovuar në vitin 2021 ka paraparë kufizimet në punët dytësore por duhet të specifikohen	Ekzistojnë procedurat për aprovimin e punës sekondare, por nuk janë të definuara qartë pozitat e ndaluara.	6	6	36	Hartimi i rregullave të veqanta për parandalim të konfliktit të interesit.	Drejtori i Përgjithshëm i IKAP-it; Drejtorja për Financa dhe Shërbime të	TM4 2024

		aktivitetet e ndaluara dhe zyrtarët mund të angazhohen në detyra nëse nuk janë të kufizuara.						Përgjithshme.	
	Deklarimi i dhuratave	Mos deklarimi i mundshëm i dhuratave.	Ekziston obligimi ligjor për deklarim të dhuratave.	4	3	12	Informimi i zyrtarëve të IKAP për pasojat e mos deklarimit të dhuratave.	Drejtori i Përgjithshëm; Drejtoria e Trajnimit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	Në vazhdimësi
2	Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve në shërbimin civil.	Angazhimi i trajnerëve kompetentë sipas fushave të organizimit të trajnimeve.	Ligji Nr. 04/L-221 për IKAP; UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.	3	10	30	Trajnimet për Trajnerë (TpT);	Zyrtari për certifikimi e trajnerëve	Në vazhdimësi
		Hartimi i programeve përmbajtësore të trajnimeve.	Ligji Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik Ligji Nr. 04/L-221 për IKAP;	4	10	40	Bashkëpunimi me institucione të ngjashme të trajnimit; Shkëmbim i programeve dhe i stafit të	Drejtori i Përgjithshëm	Në vazhdimësi

			UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.				institucioneve; Angazhim i ekspertëve.		
		Sigurimi i pjesëmarrjes përkatëse të nëpunësve civilë në trajnime.	UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP; Plani i Punës i IKAP-it.	4	10	40	Komunikimi i rregullte me Menaxherët e Burimeve Njerëzore (MBNJ) të institucioneve; Organizimi i takimeve dhe tryezave me Njësitë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) dhe departamentet kryesore të institucioneve; Organizimi i Konferencës vjetore për rolin e trajnimit në Reformën e Administratës Publike (RAP) si dhe ngritjen e performancës dhe profesionalizimit të administratës publike.	Drejtori i Përgjithshëm; Drejtoria e Trajnimit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	Në vazhdimësi

3	Planifikimi dhe Menaxhimi i Financave.	Buxheti i pamjaftueshëm për realizimin e Planit të Trajnimit.	Ligji Nr. 04/L-221 për IKAP; Ligji Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASh) 2024 - 2026 për IKAP-in	4	10	40	Centralizimi i buxhetit në IKAP në nivel vendi për trajnimet e përgjithshme; Koordinimi i aktiviteteve me të gjithë donatorët që mbështesin zhvillimi e BNJ dhe SHCK-së; Rritja e përqindjes së organizimit të trajnimeve përmes Platformës Moodle.	Drejtori i Përgjithshëm; Drejtoria e Trajnimit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	Në vazhdimësi
4	Ruajtja dhe siguria e të dhënave digjitale.	Rreziku nga qasja e personave të paautorizuar.	Ligji Nr. 04/L-221 për IKAP; UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP; Ligji Nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale; Ligji Nr. 03/L-178 për	3	10	30	Ngritja e kapaciteteve për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave për brenda institucionit. Nënshkrimi i deklaratës së konfidences nga stafi dhe trajnerët e IKAP	Drejtori i Përgjithshëm; Zyrtari i Teknologjisë së Informacionit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	TM4/2024

			klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë.						
5	Rekrutimi dhe plotësimi i vendeve të lira të punës.	Klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës sipas Rregullore përkatëse për IKAP.	Ligji Nr. 04/L-221 për IKAP; Ligji Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik; Rregullore (QRK) Nr. 10/2022 për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil; Rregullore (QRK) Nr. 15/2023 për procedurën e pranimit në Shërbimin Civil; Rregullore (ZKM) Nr. 01/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IKAP.	3	5	15	Themelimi i Komisionit për sistematizim e vendeve të punës; Rekrutimi i stafit të ri; Trajnimi i stafit.	Drejtori i Përgjithshëm i IKAP-it; Komisioni përkatës; Zyrtari i personelit.	TM1 deri TM4/2024

FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia / zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1.	Angazhimi i trajnerëve.	Trajnerë jo kompetent për të gjitha programet e trajnimit.	UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.	3	5	15	Certifikimi i trajnerëve sipas fushave kompetente	Drejtoria e Trajnimit;	TM1 deri TM4/2024
		Tarifat e pagesave jo motivuese për ekspert specifik.	UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.	3	5	15	Ndryshimi dhe plotësimi i UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.	Drejtori i Përgjithshëm i IKAP-it; Drejtoria e Trajnimit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	TM1 deri TM4/2024

		Procedurat e gjata për angazhimin e ekspertëve.	UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.	3	5	15	Ndryshimi dhe plotësimi i UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.	Drejtoria e Trajnimit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	TM1 deri TM4/2024
2	Hartimi i programeve të trajnimeve.	Mungesa e ekspertëve për hartimin e programeve adekuate.	UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.	3	5	15	Ndryshimi dhe plotësimi i UA (QRK) Nr. 13/2018 për kushtet, angazhimin, kategorizimin dhe mënyrën e pagesës së trajnerëve në IKAP.	Drejtoria e Trajnimit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	TM1 deri TM4/2024
		Mungesa e Rregullores për Trajnime.	Ligji Nr. 08/L-197 për zyrtarët	3	5	15	Hartimi i Rregullores për Trajnime.	Drejtori i Përgjithshëm i IKAP-it;	TM1 deri TM4 2024

			publik; Ligji Nr. 04/L-221 për IKAP.					Drejtoria e Trajnimit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	
3	Sigurimi i pjesëmarrjes në trajnime.	Interesimi jo i madh për vijimin e trajnimeve në IKAP.	Ligji Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik; Ligji Nr. 04/L-221 për IKAP; Plani i Punës i IKAP-it.	3	5	15	Koordinimi i aktiviteteve ne mes të IKAP-it dhe NJMBNJ-ve të institucioneve.	Drejtori i Drejtoria i Përgjithshëm i IKAP-it; Drejtoria e Trajnimit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	Në vazhdimësi
		Pjesëmarrja e vogël sipas grupeve të synuara (Drejtues i Ulët, Drejtues i Mesëm, Drejtues i Lartë).	Ligji Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik; Ligji Nr. 04/L-221 për IKAP; Plani i Punës i IKAP-it.	3	5	15	Organizimi i takimeve dhe tryezave me institucione si dhe i një konference.	Drejtori i Përgjithshëm i IKAP-it; Drejtoria e Trajnimit; Drejtoria për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	Në vazhdimësi

4	Sigurimi i buxhetit të mjaftueshëm.	Mos realizimi i Planit të Trajnimeve.	KASh 2024 - 2026 për IKAP-in; Planifikimi i financave.	3	5	15	Centralizimi i buxhetit; Rritja e buxhetit për IKAP sipas Planit të Trajnimeve; Identifikimi i donatorëve potencial.	Drejtori i Përgjithshëm i IKAP-it; Drejtorja e Trajnimit; Drejtorja për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme.	Në vazhdimësi
---	--	--	--	---	---	----	---	---	---------------

10. VENDIMI PËR MIRATIMIN DHE HYRJEN NË FUQI TË PLANIT TË INTEGRITETIT



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE
INSTITUT KOSOVA ZA JAVNU ADMINISTRACIJU
KOSOVO INSTITUTE FOR PUBLIC ADMINISTRATION



Në bazë të Nenit 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.01.2024: Drejtori i përgjithshëm i IKAP nxjerr:

VENDIM

1. Miratohet plani i integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr.005/2024, datë 15.01.2024.
2. z. Bujar Thaçi, Drejtor i Administratës, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 26.01.2024, titullari i institucionit nxjerr vendim për miratimin e Planit të Integritetit, të hartuar nga grupi punues, i caktuar me Vendim Nr.005/2024, datë 15.01.2024, të theksuar si në pikën 1 të dispozitivit të Vendimit.

z. Bujar Thaçi sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Lule Isufi, U.d. Drejtorit të IKAP

Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Personit përgjegjës;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
- Arkivës